<p>institucionit dhe vlera financiare e tyre;</p> <p>4.2. Projektet ku institucionit merr pjesë si partner dhe vlera financiare e tyre;</p> <p>4.3. Projektet në rrafshin kombëtar dhe vlera financiare e tyre;</p> <p>4.4. Projektet ndërkombëtare dhe vlera financiare e tyre.</p> <p>5. Inovacionet (risitë) – Institucionit duhet të demonstrojë se ka krijuar dije dhe njohuri të reja. Duhet të demonstrojë sa ka krijuar inovacione (nëse është në domenin e saj të veprimtarisë). Numri dhe cilësia e inovacioneve janë matës i besueshëm i suksesit të veprimtarisë së institucionit kërkimor.</p> <p>6. Gjatë vlerësimit të institucionit kërkimor, së pari duhen këto të dhëna: numrin e inovacioneve të rëndësishme në të cilat ka kontribuar institucionit kërkimor në pesë vitet e kaluara. Nëse nuk ka pasur ndonjë inovacion, atëherë duhet shikuar mundësia, nëse mund të priten ndryshime në tri vitet e ardhshme. Nëse mundësitë inovative mungojnë, atëherë duhet vlerësuar kapacitetin e institucionit kërkimor për të</p>	<p>coordinated by the institution and their financial value;</p> <p>4.2. Projects where institution takes part as partner and their financial value;</p> <p>4.3. Projects in the national level and their financial value;</p> <p>4.4. International projects and their financial value;</p> <p>5. Innovations – the institution must demonstrate that has created new knowledge. Should demonstrate that has created innovations (if it is in its domain of activity). The number and quality of innovations is a reliable gauge of the research institution's activity success.</p> <p>6. During evaluation of the research institution, first of all are needed these data: number of important innovations where the research institution has contributed in the last five years. If there was no innovation, then the possibility should be looked at, if changes can be expected in the next three years. If innovative possibilities are lacking, then the capacity of the research institution must be assessed, to change its priorities in</p>	<p>institucija i njihova finansijska vrednost;</p> <p>4.2. Projekti u kojima institucija učestvuje kao partner i njihova finansijska vrednost;</p> <p>4.3. Projekti na nacionalnom nivou i njihova finansijska vrednost;</p> <p>4.4. Međunarodni projekti i njihova finansijska vrednost.</p> <p>5. Inovacije (novosti) - Institucija mora pokazati da je stvorila nova znanja i znanje. Ona mora demonstrirati koliko je inovacija stvorena (ako je u domenu aktivnosti). Broj i kvalitet inovacija su pouzdana mera uspeha aktivnosti istraživačke institucije.</p> <p>6. Tokom procene istraživačke institucije, prvo su potrebne sledeće informacije: broj važnih inovacija koje je istraživačka institucija doprinela u proteklih pet godina. Ako nije postojala nikakva inovacija, tada bi trebalo proceniti mogućnost da li bi mogli sačekati promene u naredne tri godine. Ako nedostaju inovativne mogućnosti, kapacitet istraživačke institucije da promeni svoje prioritete treba</p>
---	--	--

<p>ndryshuar prioritetet e veta në mënyrë që të krijohet mjedisi i favorshëm për inovacione.</p> <p>7. Numri i patentave përdoret si një tregues me rëndësi i qasjes inovative dhe efekteve të punës së institucioneve kërkimore-shkencore. Patenti paraqet pronësinë ligjore mbi risinë, inovacionin dhe njihet nga zyrtar kombëtarë të patentimit.</p> <p>8. Treguesit:</p> <p>8.1. Inovacionet në pesë vitet e fundit;</p> <p>8.2. Numri i patentave të regjistruara në pesë vitet e fundit;</p> <p>8.3. Planet për krijimin e inovacioneve.</p>	<p>order to create a favourable environment for innovation.</p> <p>7. Number of patents is used as an important indicator of the innovative and approach and effects of the scientific-research institutions work. The patent presents legal ownership on innovation, and is known from national patenting offices.</p> <p>8. Indicators:</p> <p>8.1. Innovations in the last five years;</p> <p>8.2. Number of registered patents in the last five years;</p> <p>8.3. Plans for creation of innovations.</p>	<p>procenti kako bi se stvorilo povoljno okruženje za inovacije.</p> <p>7. Broj patenata se koristi kao važan indikator inovativnog pristupa i efekata rada istraživačkih institucija. Patent predstavlja pravno vlasništvo nad inovaciju i inovacija se priznaje od strane nacionalnih patentnih ureda.</p> <p>8. Indikatori:</p> <p>8.1. Inovacije pet poslednjih godina;</p> <p>8.2. Broj patenta registrovani tokom pet poslednjih godina;</p> <p>8.3. Planovi za stvaranje inovacija.</p>
<p>9. Publikimet ndërkombëtare dhe vendore – IKSH duhet të paraqesë fakte me anë të metodave bibliometrike lidhur me numrin e publikimeve shkencore ndërkombëtare të arritura nga stafi i IKSH.</p> <p>9.1. IKSH me anë Bibliometrikës do të mundësojë informata të përshtatshme online për numrin e publikimeve dhe citimeve dhe ato mund të gjenden lehtë me motorët kërkues në internet si për shembull scholar.google.com. Të dhënat për publikimet e një institucioni</p>	<p>9. International and local publications – SRI must presents facts through the bibliometrical methods regarding the number of international scientific publications achieved from the SRI staff.</p> <p>9.1. SRI through Bibliometrics will enable appropriate online informations for the number of publications and quotations and they can be easily found with research engine in the internet such as: scholar.google.com. Data on a research institution's publications show</p>	<p>9. Međunarodne i lokalne publikacije - NII treba da prezentira činjenice bibliometrijskim metodama u vezi sa brojem međunarodnih naučnih publikacija koje je postigao osoblje NII-a.</p> <p>9.1. NII preko Bibliometrije će obezbediti odgovarajuće onlajn informacije o broju publikacija i citata, a oni se lako mogu pronaći na pretraživačima na Internetu, kao što je scholar.google.com. Podaci o publikacijama istraživačke institucije</p>

<p>kërkimor tregojnë karakteristikat e njohurive të krijuara dhe aftësinë e shpërndarjes.</p> <p>9.2. IKSH do të paraqesë dëshmi në lidhje me grupimin e publikimeve dhe citateve për secilën njësi të institucionit kërkimor, duke grupuar referimet e citimet e personelit që i përket atij të IKSH, në mënyrë që të krijohet mundësia për të krahasuar jo vetëm secilin institucion kërkimor kundër simotrave të veta, por edhe secilën njësi kërkimore karshi njërive të njëjta apo të ngjashme kërkimore në institucione tjera.</p>	<p>the characteristics of knowledge generated and distribution capability.</p> <p>9.2. SRI will present evidences regarding the grouping of publications and quotations for each research institution's unit, by grouping referrals and citations of the personnel that belongs to that SRI, in order to create the opportunity to compare not only each research institution against to their similar institutions, but also each research unit towards the same or similar units in other research institutions.</p>	<p>pokazuju karakteristike stečenog znanja i sposobnosti distribucije.</p> <p>9.2. NII će predstaviti dokaze u vezi sa grupisanjem publikacija i citata za svaku jedinicu istraživačke institucije grupisanjem referata i osoblja koje pripadaju tom NII kako bi se stvorila prilika da se uporede ne samo svaka istraživačka institucija protiv svoje srodne, ali i svaka istraživačka jedinica u odnosu na iste ili slične istraživačke jedinice u drugim institucijama.</p>
<p>Neni 9 Mobiliteti i hulumtuesve</p> <p>1. Mobiliteti i hulumtuesve - lëvizshmëria e tyre nga jashtë në institucionin kërkimor dhe nga brenda në institucionet kërkimore vendore apo ndërkombëtare- është faktor shumë i rëndësishëm që mund të ndikojë në të gjitha proceset e krijimit dhe shpërndarjes së dijes.</p> <p>2. Një nga aspektet kryesore të një institucioni kërkimor është aftësia e tij për të ushtruar ndikim ndërkombëtar shkencor-teknologjik kërkimor nga hulumtuesit</p>	<p>Article 9 Mobility of researchers</p> <p>1. Mobility of researchers – their mobility outside the research institution and within the local or international research institutions – is an important factor which can affect all processes of knowledge creation and dissemination.</p> <p>2. One of the main aspects of a research institution is its ability to exercise international scientific-technological research influence from researchers sent</p>	<p>Član 9 Mobilnost istraživača</p> <p>1. Mobilnost istraživača - njihova mobilnost iz inostranstva u istraživačku instituciju i unutar lokalnih ili međunarodnih istraživačkih institucija - je veoma važan faktor koji može uticati na sve procese stvaranja znanja i širenja.</p> <p>2. Jedan od glavnih aspekata istraživačke institucije je njegova sposobnost da vrši međunarodna naučno-tehnološka istraživanja od istraživača poslatih u</p>

<p>dërguar jashtë vendit për të bërë detyra substanciale kërkimore dhe për të tërhequr njohuri relevante hulumtuese nga jashtë. Në përgjithësi, një hulumtuesi duhet t'i jepet mundësia për të punuar jashtë vendit çdo 3-5 vjet, dhe institucioni kërkimor duhet të jetë në gjendje të krijojë gatishmërinë për të prituri me institucionet e huaja. Burimet dhe prijia e hulumtuesve ndërkombëtarë japin indikacione të fuqishme për kapacitetet dhe reputacionin e institucionit kërkimor.</p>	<p>abroad, in order to carry out substantial research tasks and attract relevant research knowledge from abroad. In general, to one researcher is given the opportunity to work abroad every 3-5 years and the research institution should be able to create readiness to host with the foreign institutions. Sources and expectations of international researchers provide strong indications on the capacity and reputation of the research institution.</p>	<p>inostranstvo radi obavljanja značajnih istraživačkih zadataka i privlačenja relevantnih istraživačkih znanja iz inostranstva. Generalno, istraživaču bi trebalo dati priliku da radi u inostranstvu svake 3-5 godina, a istraživačka ustanova treba da bude u stanju da stvori spremnost da bude domaćin stranim institucijama. Resursi i očekivanja međunarodnih istraživača pružaju jake indikacije za kapacitet i reputaciju istraživačke institucije.</p>
<p>3. Vlerësimi i mobilitetit të hulumtuesve mund të mbështetet në numrin e përgjithshëm të hulumtuesve të huaj që ka pritur institucioni për më shumë se 1,5 muaj në 3 vitet e fundit dhe numri i përgjithshëm i hulumtuesve të institucionit kërkimor të dërguar jashtë vendit për më shumë se 1,5 muaj në 3 vitet e fundit.</p>	<p>3. Researchers' mobility evaluation can support the overall number of foreign researchers that institution has hosted for more than 1,5 months in the past 3 years and the overall number of researchers of the scientific institution that are sent abroad for more than 1,5 months in the past 3 years.</p>	<p>3. Procena mobilnosti istraživača može se zasnivati na ukupnom broju inostranih istraživača koji su u posljednje 3 godine čekao instituciju više od 1,5 mjeseca, a ukupan broj istraživačkih instituta poslatih u inostranstvo za većinu više od 1,5 meseca u posljednje 3 godine.</p>
<p>3.1. Treguesit:</p> <p>3.1.1. Mobilitetet jashtë vendit në tri vitet e fundit;</p> <p>3.1.2. Marrëveshjet me institucione të tjera për shkëmbimin e personelit.</p>	<p>3.1. Indicators:</p> <p>3.1.1. Mobilities abroad in the past three years;</p> <p>3.1.2. Agreements with other institutions for personnel exchange.</p>	<p>3.1. Indikatori:</p> <p>3.1.1. Mobilnost u inostranstvu u posljednje tri godine</p> <p>3.1.2. Sporazumi sa ostalim institucijama za razmenu osoblja.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 10 Lidhja me shfrytëzuesit</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Connection with users</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Veza sa korisnicima</p>
<p>1. Institucioni duhet të dëshmojë, se kërkimin shkencor që e zhvillon mbështetet në nevojat e shoqërisë dhe kërkesat e tregut, ndërkaj rezultatet e tyre vihen në zbatim dhe janë relevante për shfrytëzuesit.</p> <p>2. Institucionet kërkimore nëse përveç kërkimit akademik, përfshihen edhe në hulumtime të aplikuara, duke i vënë rezultatet e kërkimit në dispozicion të klientëve të tyre, duhet të paraqesin dëshmi të qarta.</p> <p>3. Pjesëmarrja në konsulenca ose kryerja e hulumtimeve të porositura janë veprime që nxisin veprimtarinë kërkimore dhe bëjnë që ajo t'i kontribuojë zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit, prandaj IKSH duhet të ofrojë dëshmi dhe plane në lidhje me këtë aktivitet.</p> <p>4. Treguesit:</p> <p>4.1. Pjesëmarrja e institucionit apo hulumtuesve në kërkime të aplikuara;</p> <p>4.2. Lidhjet me industrinë dhe natyra e bashkëpunimit;</p>	<p>1. The institution should prove that developed scientific research, is supported in society needs and market demands, while their results are implemented and are relevant to the users.</p> <p>2. Research institution if besides academic research, are also included in applied researches, by making available research results must provide clear evidence, by putting research results at their clients' disposal.</p> <p>3. Participation in consultations or conducting commissioned research are actions that promote research activity and make it contribute to the social and economic development of the country, therefore SRI must provide evidences and plans regarding to this activity.</p> <p>4. Indicators:</p> <p>4.1. Partication of the institution in applied researches;</p> <p>4.2. Connections to industry and nature of cooperation;</p>	<p>1. Institucija mora pokazati da se naučno istraživanje koje razvija zasniava na potrebama društva i zahteva tržišta, dok se njihovi rezultati implementiraju i relevantni su za korisnike.</p> <p>2. Istraživačke institucije, osim akademskih istraživanja, takođe su uključene u primenjena istraživanja, čineći rezultate istraživanja dostupnim svojim klijentima, treba da daju jasne dokaze.</p> <p>3. Učešće u konsultacijama ili puštanje u rad istraživačkih aktivnosti su akcije koje promovišu istraživačku aktivnost i doprinose socijalnom i ekonomskom razvoju zemlje, stoga bi NII trebala pružiti dokaze i planove vezane za ovu aktivnost.</p> <p>4. Indikatori:</p> <p>4.1. Učešće institucije ili istraživača primenjenim istraživanjima;</p> <p>4.2. Veze sa privredom i priroda saradnje;</p>

<p>4.3. Reagimi ndaj kërkesave të tregut;</p> <p>4.4. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës;</p> <p>4.5. Ndikimi i hulumtimeve në politikëbërje.</p>	<p>4.3. Reaction to market demands;</p> <p>4.4. Providing consulting services;</p> <p>4.5. The impact of research in policy making.</p>	<p>4.3. Reakcija na zahteve tržišta;</p> <p>4.4. Pružanje konsultantskih usluga;</p> <p>4.5. Uticaj istraživanja u kreiranju politike.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Siguria financiare</p> <p>1. Siguria financiare e institucionit ka ndikim thelbësor në zhvillimin e veprimtarisë së tij. Në këtë rast Institucionet Kërkimore Shkencore (IKSH) duhet të pasqyrojnë këtë gjendje dhe alternativat për të hyra financiare gjatë procesit të vlerësimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Financial security</p> <p>1. The institution's financial security has essential impact in development of its activity. In this case Scientific Research Institutions (SRJ) should reflect this condition and alternatives for financial revenues during the evaluation process.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Finansijska sigurnost</p> <p>1. Finansijska sigurnost institucije ima temeljan uticaj na razvoj svoje aktivnosti. U ovom slučaju, naučno-istraživačke institucije (NII) treba da odražavaju ovo stanje i alternative za finansijskim prihodima tokom procesa procene.</p>
<p>2. Treguesit:</p> <p>2.1. Nivelet dhe llojet e financimit në tri vitet e kaluara;</p> <p>2.2. Planet për financim në tri vitet e ardhshme;</p> <p>2.3. Mundësitë për sigurim të të hyrave komerciale.</p>	<p>2. Indicators:</p> <p>2.1. Levels and types of funding in the past three years;</p> <p>2.2. Plans for funding in the past three years;</p> <p>2.3. Opportunities for commercial revenues insurance.</p>	<p>2. Indikatori:</p> <p>2.1. Nivoe i vrste finansiranja u tri poslednje godine;</p> <p>2.2. Planove za finansiranje za tri naredne godine;</p> <p>2.3. Mogućnosti za osiguranje komercijalnih prihoda.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 12</p> <p style="text-align: center;">Vlerësimi dhe Metodologjia e Vlerësimit të Institucionit Kërkimor-Shkencor</p>	<p style="text-align: center;">Article 12</p> <p style="text-align: center;">Evaluation and Method of Scientific-Research Institution Evaluation</p>	<p style="text-align: center;">Član 12</p> <p style="text-align: center;">Evaluacija i metodologjia evaluacije istraživačke i naučne institucije</p>
<p>1. Vlerësimin për regjistrimin, licencimin, apo rilicencimin e një institucioni kërkimor-shkencor e bën Këshilli Kombëtar i Shkencës (më tutje KKSH) apo një komision ad-hoc me numër të mjaftueshëm anëtarësh nga ekspertë eminentë vendorë dhe ndërkombëtarë të fushave shkencore, i formuar nga Ministri.</p> <p>2. Vlerësimi i institucioneve kërkimore-shkencore që kanë aplikuar për regjistrim apo licencim dhe institucioneve ekzistuese organizohet në 11 hapa:</p> <p>2.1. Ministri apo KKSH në bazë të kërkesës së institucioneve të reja kërkimore-shkencore apo në mënyrë të pavarur (për institucionet ekzistuese), për çdo pesë vjet (për institucionet ekzistuese), merr vendim për vlerësimin e institucionit kërkimor-shkencor të caktuar;</p> <p>2.2. Caktohet komisioni vlerësues i përbërë nga të paktën 2 deri 4 anëtarë të KKSH apo komisioni ad-hoc (duke përfshirë 2 ekspertë të lëmisë nga radha</p>	<p>1. Evaluation for registration, licensing or re-licensing of a scientific-research institution is done by National Science Council (further NSC) or a ad-hoc commission with sufficient number of members from eminent local and international experts of scientific fields, formed by the Minister.</p> <p>2. The evaluation of research institutions that have applied for registration or licensing and of existing institutions is organized in 11 steps:</p> <p>2.1. The Minister or NSC based on the request of the new scientific-research institutions or independently (for existing institutions), every five years (for existing institutions), takes decision for evaluation of certain scientific-research institution;</p> <p>2.2. Is appointed the evaluation commission composed of at least 2 to 4 members of NSC or ad-hoc commission (including 2 subject experts from ranks</p>	<p>1. Evaluaciju registracije, licenciranja ili ponovnog licenciranja naučno-istraživačke institucije vrši Nacionalni savet za nauku (u daljem tekstu: NSN) ili ad-hoc komisija sa dovoljnim brojem članova domaćih i međunarodnih stručnjaka iz naučne oblasti koje je stvorio Ministar.</p> <p>2. Evaluacija naučnoistraživačkih institucija koja su podnela zahtev za registraciju ili licenciranje i postojeće institucije se organizuje u 11 koraka:</p> <p>2.1. Ministar ili NSN, na osnovu zahteva novih naučno-istraživačkih institucija ili na nezavisan način (za postojeće institucije), za svakih pet godina (za postojeće ustanove) donosi odluku za ocenu institucije za određeni naučnoistraživački rad.</p> <p>2.2. Određuje se komisija za evaluaciju sastavljena od najmanje 2 do 4 člana NSN-a ili ad-hoc komisije (uključujući 2 stručnjaka iz oblasti članova NSN-a ili</p>

<p>e anëtarëve të KKSH apo komisioni i rastit (ad-hoc), si dhe obligativisht 1 deri 2 ekspertë të huaj, të mirënjohur në fushën e vlerësimit të jashtëm të institucioneve shkencore me qëllim që në këtë mënyrë mund të sigurohet një vlerësim cilësor sipas standardeve ndërkombëtare, transparent, i paanshëm dhe i qëndrueshëm;</p>	<p>of NSC members or the case commission (ad-hoc), and obligatory 1 up to 2 foreign experts, well-known in the field of external evaluation of scientific institutions, in order to ensure a quality assessment according to international standards, which is also transparent, impartial and sustainable.</p>	<p>ad-hoc komisije), kao i od 1 do 2 stručnjaka stranci, poznati u oblasti eksterne evaluacije naučnih institucija, kako bi se osigurala kvalitetna procena prema međunarodnim standardima, transparentna, nepristrasna i održiva.</p>
<p>2.3. Angazhimi i ekspertëve do të jetë i mundshëm vetëm nëse Qeveria siguron një buxhet për mbulimin e shpenzimeve dhe kompensimin e punës së tyre;</p>	<p>2.3. The experts engagement will only be possible if the government provides a budget for covering the costs and compensating their work;</p>	<p>2.3. Stručno angazovanje će biti moguće samo ako Vlada obezbedi budžet za pokrivanje troškova i nadoknađuje njihov rad.</p>
<p>2.4. Kryetari i Komisionit për vlerësim, i caktuar nga Ministri apo KKSH, takon menaxhmentin e institucionit kërkimor-shkencor, i cili i nënshtrohet procesit të vlerësimit, për ta njoftuar mbi qëllimin dhe rëndësinë e vlerësimit, si dhe për të rënë dakord rreth dinamikës së procesit të vlerësimit;</p>	<p>2.4. The chairman of commission for evaluation, appointed by the Minister or NSC, meets the management of the scientific-research institution, which is subject to the evaluation process, to notify the purpose and importance of the evaluation, and to agree on the evaluation process dynamics;</p>	<p>2.4. Predsednik komisije za procenu, imenovan od strane ministra ili NSN, pripada rukovodstvu Istraživačke institucije, koji je predmet procesa evaluacije, da se obavesti svrha i važnost evaluacije i da se dogovore o dinamici procesa evaluacije.</p>
<p>2.5. Vendimi për realizimin e vlerësimit hartohet në formë të shkruar dhe përmban në vete kalendarin e vlerësimit si dhe çështjet për të cilat nevojiten informacione nga institucioni i cili vlerësohet, të cilat duhet cekur në raportin e tyre të vetëvlerësimit. Ky vendim i dërgohet institucionit</p>	<p>2.5. The decision for conducting the evaluatio is compiled in written form and contains in itself the evaluation calendar as well as the issues for which the information is needed from the institution being evaluated, which should be mentioned in their self-evaluation report. This decision is sent</p>	<p>2.5. Odluka o izvršenju procene sastavlja se u pismenoj formi i sadrži kalendar evaluacije, kao i pitanja za koje su potrebne informacije od institucije koja se ocenjuje, što treba pomenuti u svom izveštaju o samovrednovanju. Ova odluka se šalje istraživačkoj instituciji, koji je predmet</p>

<p>kërkimor-shkencor, i cili i nënshtrohet procesit të vlerësimit;</p> <p>2.6. Institucioni harton raportin e vetëvlerësimit, duke ofruar të dhënat që kërkohen për vlerësim. Për këtë qëllim iu caktohet një periudhë kohore prej dy muajsh;</p> <p>2.7. Komisioni analizon raportin e vetëvlerësimit dhe bën planin për vizitë 2 deri 3 ditore në institucion. Gjatë kësaj vizite do të zhvillohen biseda me punonjësit shkencorë dhe administrativë të institucionit kërkimor-shkencor si dhe me shfrytëzuesit eventuale të shërbimeve të tij, për të mësuar më shumë rreth punës që bëhet në këtë institucion. Do të observohen hapësirat e punës, kushtet e punës duke përfshirë mjetet e nevojshme të punës, instrumentet, metodologjitë e aplikuarat, si dhe plotësimi i kriterëve të tjera të përcaktuara me këtë dokument. Po ashtu, do të kërkohen prova për të dhënat që ka ofruar institucioni në raportin e vetëvlerësimit;</p> <p>2.8. Komisioni për vlerësimin e institucioneve shkencore harton draftraportin e vlerësimit duke ndjekur</p>	<p>to the scientific-research institution, which is subject of the evaluation process;</p> <p>2.6. The institution compiles the self-evaluation report, by providing data that are required for evaluation. For this purpose is given a two months time period;</p> <p>2.7. The commission analyses the self-evaluation report and makes the plan for a 2-3 day visit to the institution. During this visit, discussions will be held with scientific and administrative staff of the scientific-research institution and with eventual users of its services, to learn more about the work done in this institution. The working space, working conditions will be observed, including the necessary work tools, instruments, applied methodologies and fulfilment of other criteria set with this document. Also, evidence will be required for the information provided by the institution in the self-assessment report;</p> <p>2.8. The Scientific Institutions Assessment Commission prepares the draft assessment report following the</p>	<p>procene.</p> <p>2.6. Institucija izrađuje izvještaj o samoevaluaciji, pružajući informacije potrebne za ocenjivanje. U tu svrhu postavljen je period od dva meseca.</p> <p>2.7. Komisija analizira izvještaj o samooocenjivanju i obide instituciju od 2 do 3 dana. Tokom ove posete održaće se diskusije sa naučnim i administrativnim osobljem istraživačke institucije, kao i sa potencijalnim korisnicima svojih usluga, da saznaju više o radu u ovoj instituciji. Biće pregledani radni prostor, radni uslovi, uključujući neophodne alate, instrumente, primenjene metodologije, kao i ispunjavanje drugih kriterijuma koji su navedeni u ovom dokumentu, biće neophodni dokazi za podatke koje pruža Institucija u izvještaju o samovrednovanju.</p> <p>2.8. Komisija za naučno vrednovanje institucija izrađuje nacrt izvještaja o proceni sledeći format koji je naveden u</p>
---	---	---

<p>formatin e përcaktuar në shtojcë;</p> <p>2.9. Anëtarët e Komisionit do t'i raportojnë kryetarit në mënyrë individuale dhe të pavarur, e pastaj së bashku do të diskutojnë mbi gjendjen e institucionit që vlerësohet. Komisioni do të ketë për bazë standardet ndërkombëtare të punës në këto institucione shkencore;</p> <p>2.10. Draftraporti me shkrim i dërgohet institucionit kërkimor-shkencor për komente dhe nga i njëjti kërkohet në një afat kohor prej 10 ditësh të kthehet përgjigja me shkrim;</p> <p>2.11. Komisioni për vlerësim harton raportin përfundimtar me rekomandime. Këto rekomandime do të jenë në përputhje me standardet e hulumtimit në institucionet gjegjëse në Rajon, Evropë e më gjerë. Rekomandimet do të jenë me qëllim të përsosjes së punës në këto institucione, si dhe nxitjes së investimeve në këto fusha të hulumtimit shkencor, për të qenë të krahasueshëm me qendrat tjera gjegjëse jashtë vendit;</p> <p>2.12. KKSH apo komisioni i formuar nga Ministri, shqyrton raportin e</p>	<p>format specified in the appendix;</p> <p>2.9. The members of the Commission will report to the Mayor individually and independently, and together will discuss the state of the institution being evaluated. The Commission will be based on international labor standards in these scientific institutions;</p> <p>2.10. The draft report in writing is sent to the scientific research institution for comments and the same is required within 10 days to return the written reply;</p> <p>2.11. The evaluation commission compiles the final report with recommendations. These recommendations will be in line with research standards in relevant institutions in the region, Europe and beyond. The recommendations will be aimed at improving the work of these institutions and promotion of investment in these scientific-research areas, in order to be comparable with other relevant centers abroad;</p> <p>2.12. The NSC or the established commission by the Minister reviews the</p>	<p>dodatkü.</p> <p>2.9. Članovi komisije će podnositi izvještaj predsedavajućem pojedinačno i nezavisno, a zatim zajedno će raspravljati i razmatrati stanje institucije koja se ocenjuje. Komisija će imati osnove međunarodnih standarda rada u ovim naučnim institucijama.</p> <p>2.10. Nacrt pismenog izveštaja se šalje naučnoistraživačkoj instituciji za komentare i isto se traži u roku od 10 dana da se pismeni odgovor vrati.</p> <p>2.11. Komisija za evaluaciju sastavlja konačni izvještaj sa preporukama. Ove preporuke će biti u skladu sa standardima istraživanja u relevantnim institucijama u regionu, Evropi i šire. Preporuke će biti usmerene na poboljšanje rada u ovim institucijama i promocija investicija u ove oblasti naučnog istraživanja da bi bila uporediva sa drugim relevantnim centrima u inostranstvu.</p> <p>2.12. NSN ili komisija koja je sastavljena od strane ministra razmatra</p>
---	--	--

<p>komisionit për vlerësim. Kryetari i komisionit për vlerësim raporton për punën e bërë duke informuar anëtarët e KKSH apo të komisionit ad-hoc për procedurën dhe rezultatet punës, si dhe u përgjigjet komenteve eventuale të anëtarëve të KKSH apo komisionit. Në fund KKSH apo komisioni merr vendim rreth aprovimit të tij;</p>	<p>report of the evaluation committee. The Chairman of the Evaluation Commission reports on the work done by informing the members of the NSC or the ad-hoc commission on the procedure and the results of the work, as well as responds to the possible comments of the members of the NSC or the commission. At the end, NSC or the commission decides on its approval.</p>	<p>izveštaj komisije za evaluaciju. Predsedavajući komisije za procenu izveštava o obavljenom radu tako što informiše članove NSN-a ili ad-hoc komisije o postupku i rezultatima rada, kao i o odgovorima na moguće komentare članova NSN-a ili komisije. Na kraju, NSN ili komisija odlučuje o njegovom usvajanju.</p>
<p>2.13. Vendimi i KKSH bashkë me Raportin e Komisionit i dërgohet Ministrisë për procedim të mëtutjeshëm dhe në bazë të tij, ministri do ta sjell vendimin e tij përfundimtar për (ri) regjistrimin apo (ri)licencimin të institucionit kërkimor-shkencor.</p>	<p>2.13. The decision of the NSC together with the Commission Report is sent to the Ministry for further proceeding and based on it the Minister will make its final decision on (re-) registration or (re) licensing of the scientific-research institution.</p>	<p>2.13. Odluka NSN-a zajedno sa izveštajem komisije se šalje Ministarstvu radi daljeg postupka i na osnovu toga, ministar donosi konačnu odluku o (ponovnoj) registraciji ili (ponovnom) licenciranju naučno-istraživačke institucije.</p>
<p>Neni 13 Financimi i vlerësimit</p> <p>1. Shpenzimet e vlerësimit duhet të mbulohen nga vet institucionet që i nënshtrohen këtij procesi, ndërkaq në rastin e institucioneve publike, shpenzimet mbulohen nga Buxheti i Kosovës.</p> <p>2. Anëtarët e KKSH apo të komisionit ad-hoc, e kryejnë detyrën e vlerësuesit në kuadër të obligimeve të rregullta si anëtarë të këtij organi dhe kundrejt pagesës së</p>	<p>Article 13 Funding the Evaluation</p> <p>1. Evaluation costs should be covered by the institutions that are subject to this process, whereas in the case of public institutions, the expenditures are covered by the Kosova Budget.</p> <p>2. Members of the NSC or the ad-hoc commission perform the evaluator's tasks within regular duties as members of this body and against the payment made for this</p>	<p>Član 13 Finansiranje evaluacije</p> <p>1. Troškove evaluacije trebaju biti pokriveno od institucije koja su predmet ovog procesa, dok su u slučaju javnih institucija troškovi se pokrивaju od Budžeta Kosova.</p> <p>2. Članovi NSN-a ili ad-hoc komisije obavljaju dužnosti procenjivača u okviru redovnih dužnosti kao članovi ovog organa i protiv isplaćene za tu svrhu. U</p>

<p>akorduar për këtë qëllim. Ndërkaq, angazhimi i ekspertëve të jashtëm, duhet të kompensohet nga Buxheti i Kosovës përmes kontratave mbi vepër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14</p> <p>Humbja e licencës për punë kërkimore-shkencore dhe heqja nga regjistri i IKSH</p>	<p>purpose. Meanwhile, the engagement of external experts should be compensated by the Kosova Budget through work contracts.</p> <p style="text-align: center;">Article 14</p> <p>Loss of license for scientific-research work and removal from the register of NSC</p>	<p>međuvremenu, angažovanje vanjskih stručnjaka treba nadoknaditi iz Budžeta Kosova putem ugovora o radu.</p> <p style="text-align: center;">Član 14</p> <p>Gubitak licencije za naučno- istraživački rad i uklanjanje iz registra NII-a</p>
<p>1. Një institucion i regjistruar dhe i licencuar më parë, në rast të mosvlerësimit pozitiv, e humb të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.</p>	<p>1. A previously registered and licensed institution, in the case of a non-positive assessment, loses the right to exercise scientific-research activity.</p>	<p>1. Pre registrovana i licencirana institucija, u slučaju ne-pozitivne procene, izgubi pravo na naučno istraživačku delatnost.</p>
<p>2. Çdo institucion që nuk e kalon vlerësimin për dhënien e licencës apo për përtrijen e licencës për punë kërkimore-shkencore, duhet brenda një viti kalendarik të aplikojë përsëri për marrjen e licencës.</p>	<p>2. Any institution that does not pass the evaluation for granting a license or for renewing the license for scientific research must apply again for obtaining a license within one calendar year.</p>	<p>2. Svaka institucija koja ne proglasi procenu za izdavanje dozvole ili izdavanje dozvole za naučno istraživački rad, ponovo se primenjuje u roku od jedne kalendarske godine radi dobijanja dozvole.</p>
<p>3. Institucionet që dështojnë dy herë radhazi për t'u licencuar, e humbin statusin e institucionit kërkimore-shkencor dhe ç'regjistrohen nga regjistri i IKSH-ve të cilin e mban MASHT nëse kanë qenë të regjistruar më herët.</p>	<p>3. Institutions that fail twice in a row to be licensed lose the status of the scientific-research institution and are deregistered from the register of NSC which is kept by MEST if they have been earlier registered.</p>	<p>3. Institucije koja dva puta zaredom prestaju da budu licencirana gube status institucije za naučna istraživanja i uklanjaju se iz registra NII-a koje održava MONT ako su ranije bili registrovani.</p>

SHTOJCA 1

Treguesit për vlerësim

Grupi	Nëngrupi	Treguesit
1. Treguesit e përgjithshëm		<p>1.1. Vizioni i zhvillimit për periudhën e caktuar kohore</p> <p>1.2. Konteksti socio- ekonomik</p> <p>1.3. Qasja në informacione shkencore</p> <p>1.4. Konkurrenca</p> <p>1.5. Sa është i ndikuar institucioni nga procesi i tranzicionit</p> <p>1.6. Cili është bashkëpunimi me institucionet tjera (në vend dhe jashtë) që kanë veprimtari të ngjashme apo që shfrytëzojnë shërbimet (rezultatet), e tij.</p> <p>1.7. Misioni</p> <p>1.8. A ka ndryshuar gjatë periudhave të ndryshme misioni, sa ka arrit t'ju përshtatet rrethanave aktuale socio- ekonomike</p> <p>1.9. Aktivitetet kryesore aktuale</p> <p>1.10. Sa arrinë të shfrytëzohen rezultatet e arritura nga institucioni ne nivel vendi dhe me gjerë</p>
2. Masa kritike	2.1. Huluntuesit	<p>2.11.1. Numri i përgjithshëm i huluntuesve sipas gjinive</p> <p>2.11.2. Numri i huluntuesve me doktoratë ose më shumë</p> <p>2.11.3. Numri i huluntuesve me magjistraturë ose master</p> <p>2.11.4. Numri i huluntuesve të moshës nën 35 vjeç</p> <p>2.11.5. Numri i përgjithshëm i punonjësve në institucion si ekuivalent i orarit të plotë të punës</p> <p>2.11.6. Numri i përgjithshëm i huluntuesve në institucion si ekuivalent i orarit të plotë të punës</p>
	2.2. Infrastruktura fizike	<p>2.2.1. Infrastruktura huluntuese, a mundëson që të jetë konkurrent në raport me institucionet në regjion dhe më gjerë.</p> <p>2.2.2. Mundësitë që infrastruktura huluntuese ofron për bashkëpunim ndërkombëtar</p> <p>2.2.3. Sipërfaqja e objekteve në posedim, cilësia e tyre</p> <p>2.2.4. A ofrojnë kushte të mjaftueshme për punë</p> <p>2.2.5. Laboratorët</p> <p>2.2.6. Bibliotekat</p> <p>2.2.7. Objektet përcjellëse</p> <p>2.2.8. Mjetet e transportit (punës në terren)</p>